



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-9835/24 datë:19.04.2024



Npi – 01/143 datë: 29.04.2024

Duke u bazuar në nenin 40.2 shkronja (b dhe c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008); Nenin 58.3 të Ligjit, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048; Neni 27 i Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023; Nenin 2.3, dhe nenin 7.1 shkronja (i), dhe nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Si dhe mbi bazën e prezantimit të Propozim-Vendimit për ndryshimin e Vendimit të Kuvendit Npi-01/75 të datës 26.02.2024 për bartjen e të hyrave nga viti 2023 në vitin 2024 nga Drejtoria Komunale për Buxhet dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Shtimes pasi diskutoi dhe analizoi propozimin, në mbledhjen e mbajtur më 29.04.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT Npi – 01/75 DATË: 26.02.2024 PËR MIRATIMIN E BARTJES SË TË HYRAVE NGA VITI 2023 NË VITIN 2024

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në Seancën e -IV- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 29.04.2024, me shumicën e votave miratoi Vendimin për ndryshimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi – 01/75 datë: 26.02.2024, për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2023 në vitin 2024, sipas tabelës në vazhdim:

Nr.	Kodi i OB	Kodi Ekonomik	Kodi i propozuar i programit për vitin 2023	Kodi i projektit në vitin 2024	Programi Buxhetor	Emërtimi i projektit	Ndryshimi i propozuar për vitin 2024 në €
1	617	30	163(16307)	53480	Administrata dhe Personeli	Blerja e veturave për Administratën Komunale Snëhtime	10,000.00€
2		30	730(73450)	53578	Shërbimet e shëndetësisë primare	Blerja e pajisjeve mjeksore per QKMFë	7,000.00€
3		30	730(73450)	55152	Shërbimet e shëndetësisë primare	Blerja e Autoambulances per QKMF-në (me paisje speciale)	8,876.00€
4		13	660(66340)		Planifikim Urban, Mjedisi dhe Inspeksion	Mallra dhe Sherbime	60,000.00€
5		13	180(18451)		Menaxhimi i katastrofave Natyrore	Mallra dhe Sherbime	203,066.71€
6		13	920(93180)		Arsimi Fillor	Mallra dhe Sherbime	21,543.32€
7		13	920(94380)		Arsimi i Mesëm	Mallra dhe Sherbime	16,911.73€

8	13	180(18411)	Zjarrfikësit dhe Inspektimet	Mallra dhe Sherbime	12,000.00 €
9	20	480(48007)	Zhvillim Ekonomik	Subvencione dhe Transfere	28,200.00€
10	20	755(75531)	Sherbimet Sociale	Subvencione dhe Transfere	45,000.00€
11	20	850(85007)	Shërbimet kulturore	Subvencione dhe Transfere	17,614.59€
12	20	470(47047)	Zhvillimi dhe Inspektimi Bujqësor	Subvencione dhe Transfere	18,711.00€
				TOTAL:	448,923.35€

II

A r s y e t i m: Komuna e Shtimes ka pas tejkalim të Planit Buxhetor nga të hyrat vetanake në vitin 2023 e të cilat duhet të barten për shpenzim në vitin 2024. Propozim-vendimin e kemi paraqitur në Kuvend i cili është miratuar me datën 26.02.2024 me vendimin numër Npi-01/75. Më datën 18.04.2024 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) Departamenti i Thesarit, i ka alokuar shumën e mjeve financiare prej 179,829.70€ e planifikuar nga të hyrat vetanake për vitin 2023, në ato nën-programe ku edhe është planifikuar. Mirëpo shuma e mbetur prej 448,923.36€ nga të hyrat vetanake të vitit 2023 ka mbetur e pa planifikuar për shpenzim në vitin 2024, prandaj kemi qenë të obliguar që ta sjellim në Kuvend për miratim, sepse ka ndryshim të strukturës së buxhetit në raport me këto mjete financiare.

- Në bazë të Propozimit për tejkalimin e planit të buxhetit nga të Hyrat Vetanake të vitit 2023 që do të barten në vitin 2024 ku kemi pasur rritje për 448,923.35€. Në kategorin e shpenzimeve kapitale, do të barten shuma prej 25,876.00€ në nën programin Administrata dhe Personeli shuma prej 10,000.00€ ne projektin Blerja e veturave për Administratën Komunale ne Shtime, dhe ne nën programin Sherbimet e shëndetësisë primare shuma prej 8,876.€ ne projektin Blerja e Autoambulances për QKMF-në (me paisje speciale) dhe ne projektin Blerja e pajisjeve mjekësore për QKMF-në në shumë prej 7,000.00€
- Ne kategorine ekonomike Mallra dhe Shërbime shuma prej 313,521.76€ në ato nën programe si në Plaifikimi Urban dhe Inspekcioni, Menaxhimi i katastrofave natyrore, Arsim Fillor, Arsim i Mesem, Zjarrfikësit dhe Inspektimet për mbulimin nevojave të tyre dhe obligimeve si pasoj e rritjes se çmimeve (blerja e druve, mirëmbajtje të ndryshme, furnizime të ndryshme, blerja e barnave etj).
- Në kategorin ekonomike Subvencione dhe Transfere shuma prej 109,525.59€ është e planifikuar në nën programin Zhvillimi dhe Inspektimi Bujqësor për mbulimin e shpenzimeve të fermerëve si dhe në nën programin Sherbimet Kulturore për financimin e klubeve sportive ku kërkesat e tyre kan qenë shumë më të larta se shuma e ndarë me buxhet, Zhvillim Ekonomik, Sherbimet Sociale për mbulimin e shpenzimeve te tyre.

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga data e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Ministrisë të Financave dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi